



V E N D I M
K.P.P. 388/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të BOE “Ecomedica” sh.p.k & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt: Loti 1 “*Trajtimi i mbetjeve infektive spitalore*”, me nr. REF-43177-01-31-2018, me fond limit 13,747,200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

Ankimues:

BOE “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k
Adresa: *Lagjia Popullore, Rr. “Brigada 10 Sulmuese, Shijak, Durrës”.*

Autoriteti kontraktor:

Spitali Rajonal Fier.
Adresa: *Lagjia “1 Maj”, Rr. “Invalidët e Luftës”, Fier.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 01.02.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt: Loti 1 “Trajtimi i mbetjeve infektive spitalore”, me nr. REF-43177-01-31-2018, me fond limit 13,747,200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.

II.2 Në datën 13.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 16.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------------------------------------|
| 1. “Ecomedica” & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k | 10,596,800 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 2. “Ecoriciklim” sh.p.k. | 11,971,520 lekë pa tvsh Kualifikuar; |
| 3. “Medi-Tel” sh.p.k. | 13,460,800 lekë pa tvsh Kualifikuar; |

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se BOE “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

“Nuk ploteson numrin mesatar per 10 punonjes per tre muajt e fundit Tetor – Nentor – Dhjetor 2017 kriter ky i parashikuar ne shtojcen nr.8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nen titullin “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 3.2.2 ke percaktohet se “Te kete mesatarisht te pakten 10 punonjes te siguruar per ushtrimin e aktivitetit normal te shoqeruar me vertetim nga Administrata Tatimore per tre muajt e fundit Tetor – Nentor – Dhjetor 2017”. Nuk ploteson Shërbime të se njejtës natyre te realizuara (nga subjekti juaj) ne 3 vitet e fundit ne nje vlere sa 40% te vleres se fondit limit per lotin 1 “Trajtimi i mbetjeve infektive spitalore” kriter ky i parashikuar ne shtojcen nr.8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” nen titullin “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 3.2.1 ke percaktohet se: Per kontrata me institucionet shtetore duhet te paraqitet kontrata, vertetim realizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes se sherbimit, ku shënohen datat, shumat e sherbimeve të realizuara (Disa prej faturave nuk jane te pajisura me firma nga subjekti dhe kontratat nuk jane te shoqeruara me vertetim realizimi.)”

II.5.Në datën 21.03.2018 BOE ankimues “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1084/2 Prot. datë 20.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura në ankesë.

II.7.Në datën 25.01.2018 BOE ankimues “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Skualifikimi jone nga KVO i AK nuk eshte ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi per arsyet si vijon: I. Në lidhje me numrin e punonjësve: Në Dokumentat e Tenderit të publikuara me njoftimin e kontratës, vetë AK në Shtojcën 8 (fq.27) pika 3.2.2 ka kërkuar: "Te kete mesatarisht te pakten 10 punonjes te siguruar për ushtrimin e aktivitetit normal te shoqeruar me vertetim nga Administrata Tatimore per tre muajt e fundit Tetor-Nentor - Dhjetor 2017. " Meqënëse AK këtë arsye skualifikimi e lidh me mosplotësimin nga operatori Ecomedica të numrit të punonjësve, sqarojmë si vijon: 1. Oferta jonë në këtë procedurë është paraqitur si ofertë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Ecomedica sh.p.k. dhe V.A.L.E Recycling sh.p.k. VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në nenin 74/3 të saj përcakton se: "Secili prej anëtarëve të këtij

bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë shërbim apo furnizim të përcaktuara në akt marrëveshje. " 2. Sipas Marrëveshjes së Bashkimit të lidhur para noterit nga operatorët pjesëmarrës të BOE, është përcaktuar që përqindja e pjesëmarrjes do të jetë: Ecomedica 65% V.A.L.E. Recycling 35%. Pra, sipas kësaj ndarjeje, detyrimi i Ecomedica-s është që të përmbushë këtë kriter duke pasur mesatarisht të paktën 6.5 punonjës të siguruar për tre muajt Tetor Nentor Dhjetor 2017 dhe jo sic pretendon KVO i AK. Vërtetimet e depozituara në SPE nga BOE për Ecomedica tregojnë qartë se ky kriter është përmbushur, pasi Ecomedica ka pasur të siguruar punonjësit si vijon: Tetor 2017: 8 punonjës Nentor 2017: 9 punonjës Dhjetor 2017: 8 punonjës Pra, duke qenë se ky kriter është përmbushur nga BOE, rezulton se KVO ka gabuar duke e përdorur si shkak për skualifikimin. II. Në lidhje me shërbimet e ngjashme: Në Dokumentat e Tenderit të publikuara me njoftimin e kontratës, vetë AK në Shtojcën 8 (fq.26) pika 3.2.1 ka kërkuar: "Shërbime të së njëjtes natyre të realizuara (nga subjekti juaj) në 3 vitet e fundit në një vlerë sa 40% të vlerës së fondit limit për lotet të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme. Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata, vërtetim realizimi ose dhe fatura tatimore të shitjes së shërbimit, ku shënohen datat, shumat e shërbimeve të realizuara. Ose Në rastin e shërbimeve me subjektet private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. " Meqënëse AK këtë arsye skualifikimi e lidh me mosplotësimin nga operatori Ecomedica të numrit të punonjësve, duke pretenduar se: "(Disa prej faturave nuk janë të pajisura me firmë nga subjekti dhe kontratat nuk janë të shoqëruara me vërtetim realizimi.)", sqarojmë si vijon: 1. Arsyetimi i AK se disa nga faturat nuk pranohen si dëshmi për shërbime të ngjashme, pasi "nuk janë të pajisura me firmë nga subjekti", është i pamështetur në ligj, dhe në vetë Dokumentat e Tenderit të publikuara nga AK pasi VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në nenin 28/3 përcakton se: "Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." dhe vetë AK ka kërkuar në Dokumentat e Tenderit: "vërtetim realizimi ose dhe fatura tatimore të shitjes së shërbimit ku shënohen datat shumat e shërbimeve të realizuara" Sic shihet nga përcaktimet e sipërcituara, në asnjë moment nuk është përcaktuar si detyrim që faturat të jenë të pajisura me firmë nga subjekti, por vetëm që në to të shënohen "datat, shumat e shërbimeve të realizuara", kusht i cili është i përmbushur, pasi të gjitha faturat e dorëzuara janë të plota me përshkrimin e shërbimit, datat dhe shumat përkatëse. 2. Arsyetimi i AK se disa nga kontratat nuk janë të shoqëruara me vërtetim realizimi është i pabazuar si në dispozitën e nenit 28/3 të sipërcituar, edhe në Shtojcën 8 pika 3.2.1 të Dokumentave të Tenderit, pasi AK ka kërkuar që kontratat e shërbimeve të ngjashme të shoqërohen me vërtetim realizimi dhe/ose fatura tatimore të shitjes, pra kushti është alternativ dhe jo kumulativ dhe kriteri quhet i plotësuar si në rastin kur paraqitet vërtetim realizimi dhe fatura ashtu dhe në rastin kur paraqitet vërtetim

realizimi ose fatura. 3.Oferta jonë në këtë procedurë është paraqitur si ofertë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Ecomedica sh.p.k. dhe V.A.L.E Recycling sh.p.k. VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 74/3 të saj përcakton se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në marrëveshje.” Sipas Marrëveshjes së Bashkimit të lidhur para noterit nga operatorët pjesëmarrës të BOE, është përcaktuar që përqindja e pjesëmarrjes do të jetë: Ecomedica 65%; V.A.L.E. Recycling 35%. Sipas kësaj ndarjeje, dhe duke marrë parasysh faktin që 40% e vlerës së fondit limit është 5.498.880 Lekë, detyrimi i Ecomedica-s është që të përmbushë këtë kriter duke vërtetuar si shërbime të ngjashme 65% të shumës së mësipërme, pra 3.574.272 lekë. Pra, edhe nëse do të merrnim për bazë arsyetimin e KVO së AK (që sidoqoftë nuk është i ligjshëm), Ecomedica e plotëson këtë shumë duke iu referuar shërbimeve të ngjashme për të cilat ka depozituar dëshmitë si vijon:

Spitali Rajonal Kukës (paraqitur kontrata + vërtetim) 1.180.000 leke

Spitali Rajonal Berat (paraqitur kontrata + vërtetim) 2.443.000 lekë

Spitali Mallakastër (paraqitur kontratë + fatura e nënshkruar) 7.666 lekë

Spitali Bilisht uaraa itur kontratë + fatura nënshkruara + vulë thesari 90.022 lekë

Totali: 3.720.688 lekë

Pra, edhe sikur të merrnim parasysh pengesat artificiale të nxjerra nga KVO e AK, përsëri vetëm nga kontratat e ngjashme të shoqëruara me vërtetim realizimi dhe fatura të nënshkuara (pa llogaritur ato që AK nuk konsideron), rezulton se Ecomedica përsëri e plotëson madje e tejkalon me 146.414 lekë minimumin e kërkuar nga AK si kriter kualifikues.[...]”

Public Health Sector

II.8.Në datën 16.04.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1152/1prot., datë 10.04.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[...]Per kontrata me institucionet shtetore duhet te paraqitet kontrata, vertetim realizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes se shërbimit, ku shënohen datat, shumat e shërbimeve të realizuara (Disa prej faturave nuk jane te pajisura me firma nga subjekti

dhe kontratat nuk janë të shoqëruara me vertetim realizimi.)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 3.2.1 të shtojcës 8 Loti I, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“3.2.1 Shërbime të së njëjtes natyre të realizuara (nga subjekti juaj) në 3 vitet e fundit në një vlerë sa 40% të vlerës së fondit limit për lot / lotet të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet. Kjo do të vertetohet me dokumentat e mëposhtme. Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata, vertetim realizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes së shërbimit, ku shënohen datat, shumat e shërbimeve të realizuara Ose Në rastin e shërbimeve me subjektet private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.”

III.1.2. Operatorët ekonomikë “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para një noteri Nr.659Rep., Nr.478Kol. Referuar kontratës së bashkëpunimit të mësipërme parashikohet se “ [...] Palët deklarojnë dhe bien dakord se përqindja respektive e pjesëmarrjes në këtë bashkim është si vijon: VALE: 35%; ECOMEDICA: 65%[...]”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.5. Neni 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokurë duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të

bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri BOE ankimues “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, ka dorëzuar, një sërë kontratash shërbimi me autoritete kontraktore, fatura tatimore me autoritete kontraktore dhe fatura tatimore me blerës subjekte private.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me shërbimet e të njëjtës natyre të kryera gjatë tre viteve të fundit, konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecomedica” sh.p.k.” sh.p.k referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër kryerjen e 65% të shërbimit, për këtë arsye, operatori ekonomik “Ecomedica” sh.p.k, referuar përqindjes së marrë përsipër duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se ka kryer shërbime të së njëjtës natyre gjatë tre viteve të fundit në vlerën 3,574,272 lekë. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi, Komisioni konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ka paraqitur një sërë kontratash shërbimi me autoritete kontraktore, fatura tatimore me autoritete kontraktore dhe fatura tatimore me subjekte private, por vetëm disa prej tyre janë paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni vëren se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecomedica” sh.p.k.” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për kontratat e shërbimit të lidhura me autoritetin kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës nr.88prot, datë 18.10.2017 me vlerë 1,160,000 lekë dhe nr.1/1prot., datë 18.08.2017 me vlerë 600,000 lekë; kontrata e shërbimit e lidhur me Spitalin Mallakastër nr.341prot, datë 15.11.2017 me vlerë 7,666 lekë; kontrata e shërbimit e lidhur me Spitalin Bilisht nr.953prot, datë 05.12.2017 me vlerë 90,000 lekë, si dhe kontrata e lidhur me autoritetin kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat nr.1294prot, datë 02.10.2017, me vlerë 1,080,000 lekë, të cilat në total arrijnë vlerën 2,937,688 lekë. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Ecomedica” sh.p.k është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanata të kualifikimit, pasi vlera e shërbimeve të fundit të së njëjtës natyre është më e vogël se ai që duhet të plotësohej (3,574,272 lekë) referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: *”Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i*

gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar zotërojnë eksperiencën e duhur në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ecomedica” sh.p.k nuk ka vërtetuar se zotëron eksperiencën e duhur për periudhën e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se BOE ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.* Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Ecomedica” sh.p.k. & “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt: Loti 1 “*Trajtimi i mbetjeve infektive spitalore*”, me nr. REF-43177-01-31-2018, me fond limit 13,747,200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 660 protokoli Datë 03.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha